



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 60

Prishtinë, më 15 tetor 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi- kryetar i Komisionit, Haki Demolli, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Albulena Haxhiu, Jasmina Zhivkoviç dhe Armend Zemaj (Ishte prezent kur shqyrtohej pika e fundit e rendit të ditës).

Munguan: Behar Selimi, Mufera Şinik, Amir Ahmeti dhe Ardian Gjini.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Bekim Kodraliu- OSBE; Visar Smajlaj – ekspert; Lumnije Murati – ZPRK; Rebeka Maliqi, Arben Shamolli – ISKP; Shkëlzen Gërxhaliu – praktikant.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës;
3. Shqyrtimi i propozimit për anëtarë të Këshillit në Komisionin për Ndihmë Juridike Falas, të propozuar nga Ministria e Drejtësisë;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04 /L-145 për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjister për sendet e luajtshme;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë në pajtim me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 04-P-105;
7. Shqyrtimi i kërkesës së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, nr. 6032;
8. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Albulena Haxhiu – Sa i përket pikës nr. 6, ajo propozoi që të shtyhet për faktin se Alma Lama, e cila e ka propozuar këtë Projektligj, nuk është prezent, gjithashtu nuk kemi ende një mendim të Gjykatës Kushtetuese nëse ligji është në përputhshmëri me Kushtetutën.

Kryetari – Tha se në këtë fazë, Komisioni nuk është i autorizuar të rekomandojë miratimin apo mosmiratimin e tij në parim. Kjo çështje bie në fushëveprimin e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional raportues.

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës

Kryetari – I njoftoi me Propozimvendimin e Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës. Anëtarët e propozuar për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës janë: Fejzullah Hasani, Adem Vokshi, Suzana Sejdiu, Ivan Çukaloviq, Meleqe Behxheti, Mirlinda Batalli, Asllan Bilalli. Për zëvendësues të anëtarëve të Komisionit u propozuan këta kandidatë: Bajram Ukaj, Haxhi Gashi, Korab Sejdiu, Visar Morina, Safet Haxha, Nebojsa Boriqiq, Qerim Qerimi. Sekretar i Komisionit është propozuar Elbasan Dervishaj.

Arsim Bajrami – Tha se është e nevojshme që Komisioni të formohet sa më parë për faktin se është një numër i madh i kandidatëve, të cilët janë të interesuar për të dhënë këtë provim dhe të fitojnë të drejtën për t'u zgjedhur gjyqtarë dhe prokurorë. Gjithashtu, ai shtoi se formulimi: “plotësimi i Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës” do të duhej të ishte: “formimi”, për faktin se asnjë nga anëtarët nuk ka qenë pjesë e Komisionit në të kaluarën. Ai propozoi që të procedohet kjo listë, për shkak se të gjithë kandidatët janë profesionalë dhe përkojnë me lëmin, gjithashtu janë plotësuar edhe kriteret e përfaqësimit gjinor dhe etnik.

Albulena Haxhiu – Ajo tha se shumica e anëtarëve janë profesionalë dhe i plotësojnë kushtet, mirëpo fakti që i tërë ky proces varet nga ministri i Drejtësisë, siç është organizimi i provimit, emërimi i kryesuesit dhe anëtarëve për provimin e jurisprudencës, nënkupton se këtu ka ndikim të drejtpërdrejtë të ekzekutivit. Në rrethana normale, do duhej të themelohej një shkollë e veçantë për këtë çështje, me këshill drejtues, të përbërë nga kryetari i Gjykatës Supreme, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, dekani i Fakultetit Juridik dhe drejtuesi i Odës së Avokatëve. Një kompetencë e tillë është logjike e gabuar dhe e mbrapshtë, prandaj tha se do të abstenojë në këtë çështje.

Haki Demolli – Tha se formulim më i saktë do të ishte: “zgjedhja e Komisionit” dhe jo “plotësimi i Komisionit”, kurse sa i përket kandidatëve, ai tha se e kanë përkrahjen e tij, për shkak se kanë përgatitje

profesionale dhe ka kandidatë të cilët e njohin mirë praktikën gjyqësore, gjithashtu edhe teorinë. Shihet se janë përmbushur edhe kriteret e përfaqësimit gjyqësor dhe etnik.

Halit Krasniqi – Vlerësoi se ekipi është shumë kompetent dhe profesional. Ministria i është qasur me seriozitet kësaj çështjeje dhe janë eliminuar shumë dobësi, të cilat kanë ekzistuar në të kaluarën.

Në momentin e votimit, prezent ishin 6 deputetë.

Komisioni për Legjislacion, me 4 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

I. Të miratohet Propozimvendimi i Ministrisë së Drejtësisë, për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës, me anëtarët dhe zëvendësit e tyre dhe sekretarin e Komisionit, si në vijim:

1. Dr. sc. Fejzullah Hasani- kryetar i Komisionit, pyetës për lëndën: E drejta penale (materiale dhe procedurale), zëvendësanëtar i Komisionit, dr. sc. Bajram Ukaj.
2. Adem Vokshi – anëtar i Komisionit, pyetës për lëndët: E drejta civile (materiale dhe procedurale), familjare, trashëgimore dhe e drejta detyrimore, zëvendësanëtar i Komisionit, dr. sc. Haxhi Gashi.
3. Suzana Sejdiu - anëtare e Komisionit, pyetëse për lëndën: E drejta tregtare (ekonomike), zëvendësanëtar i Komisionit, dr. sc. Korab Sejdiu.
4. Prof. dr. Ivan Çukaloviç- anëtar i Komisionit, pyetës për lëndën: Parimet dhe struktura kushtetuese dhe organizimi i gjyqësorit, zëvendësanëtar, dr. sc. Visar Morina.
5. Meleqe Behxheti - anëtare e Komisionit, pyetëse për lëndën: E drejta e punës, zëvendësanëtar, mr. sc. Rafet Haxha.
6. Prof. dr. sc. Mirlinda Batalli - anëtare e Komisionit, pyetëse për lëndën: E drejta administrative, zëvendësanëtar, Nebojsa Boriqiç.
7. Prof. dr. Asllan Bilalli, anëtar i Komisionit, pyetës për lëndët: E drejta ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut, zëvendësanëtar, dr. sc. Qerim Qerimi.
8. Elbasan Dervishi, sekretar i Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës.

3. Shqyrtimi i propozimit për anëtarë të Këshillit në Komisionin për ndihmë juridike falas, të propozuar nga Ministria e Drejtësisë

Kryetari – Tha se në mbledhjen e datës 19 shtator 2012, jemi pajtuar se nuk është plotësuar kushti ligjor për të përzgjedhur kandidatin nga Ministria e Drejtësisë, andaj kemi vendosur që të kërkojmë nga Komisioni i Ndihmës Juridike, që të veprojë në pajtim me ligjin për ta plotësuar kushtin ligjor me propozime të reja nga Ministria e Drejtësisë. Propozimi i ri nga Ministria e Drejtësisë është Alban Sutaj dhe tani kemi tri propozime: Lulzim Alijaj, Sokol Zogaj dhe Alban Sutaj. Ne duhet ta propozojmë njërin prej tyre.

Në momentin e votimit, prezent ishin 6 deputetë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

Përkrahet si anëtar i Këshillit, në Komisionin për Ndihmë Juridike Falas, të propozuar nga Ministria e Drejtësisë, z . Alban Sutaj.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04 /L-145 për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04 /L-145 për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-145 për Organet qeveritare për shoqërinë e informacionit, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund të procedohet për shqyrtim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme

U shqyrtua raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme dhe nuk kishte vërejtje nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-136 për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund të procedohet për shqyrtim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, në pajtim me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, nr. 04-P-105

Komisioni e shqyrtoi Projektligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, duke vepruar në pajtim me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr. 04-P-105.

Komisioni vlerësoi se në këtë fazë nuk është i autorizuar të rekomandojë miratimin apo mosmiratimin e tij në parim. Kjo çështje bie në fushëveprimin e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional raportues.

7. Shqyrtimi i kërkesës së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, nr. 6032.

U shqyrtua kërkesa e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për interpretim ligjor, lidhur me çështjen se drejtorët e klinikave a i takojnë kategorisë së shërbyesve publikë, apo kategorisë së shërbyesve civilë.

Komisioni vlerësoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e tij, andaj kërkesa si e tillë procedohet për shqyrtim të mëtejme në Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si komision funksional.

8. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Komisioni e shqyrtoi në parim Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit për t'u proceduar për shqyrtim dhe për miratim në parim, prandaj vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet në parim Projektligji për ekzekutimin e sanksioneve penale 04/L-149.

9. Të ndryshme

Albulena Haxhiu – Tha se Komisioni për Legjislacion, por edhe komisionet e tjera, e kanë për detyrë që të mbikëqyrin zbatueshmerinë e ligjit nëpër institucione të tjera. Ajo shtoi se do të duhej të vizitohen institucione të tilla, siç janë burgjet dhe të shihet se sa po zbatohet ligji dhe a kanë probleme me legjislacionin këto institucione.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:

Arben Gashi

Stafi Mbështetës i Komisionit.